



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr 7, Date 26/01/2001

MBI

**NXJERRJEN JASHTË PËRDORIMIT TË MAKINERIVE, KALIMIN KAPITAL
TË OBJEKTEVE DHE MJETEVE KRYESORE DHE NJË PROPOZIM PËR
PRIVATIZIM TË MAKINERIVE TË NDERMARRJES FONDERIA E UZINËS
MEKANIKE TIRANË DHE UZINËS MEKANIKE TIRANË**

Këshilli Bashkiak i Tiranës i mbledhur më dt.26.01.2001 pasi shqyrtoi relacionin “Mbi nxjerrjen jashtë përdorimit të makinerive, kalimin kapital të objekteve dhe mjeteve kryesore dhe një propozim për privatizim të makinerive të ndërmarrjes Fonderia e Uzinës Mekanike dhe Uzinës Mekanike Tiranë”, të paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe në mbështetje të ligjit nr.8652 dt.31.07.2000 kreu 1 neni 4, pika 3, në V.K.R.T.SH. nr.37 dt.01.12.1998 V.K.M nr.225 dt.05.05.2000 V.K.M. nr.153 dhe 170 dt.03.04.1993 V.K.M nr.192 dt.20.03.1998, V.K.M nr.378 dt.12.08.1999

V E N D O S I

1. a. Nxjerrjen jashtë përdorimit të 37 makinerive të ndërmarrjes Fonderia e Uzinës Mekanike (F.U.M), sipas listës së paraqitur në relacionin me vlerë 2117395 lekë
b. Përdorimin si skrap të 37 makinerive me vlerë të mbetur 704318 lekë dhe kalimin kapital të tij, Ministrisë së Drejtorisë
2. Kalimin kapital të makinerive të repartit dhe laboratorit të F.U.M. gjithsej 48 copë me vlerë 5593846.4 lekë sipas listës së paraqitur në relacionin dhe magazinës së mjeteve të xhiros, sipas gjëndjes në kontabilitet në datën e marjes në dorëzim, në Uzinën e Pjesëve të Ndërrimit për Autotraktorë (U.P.N.A)

3. Kalimin kapital të objektit ndërtimor dhe inventarit ekonomik me vlerë totale 6.603.606 lekë, në gjendjen që është, të ndërmarrjes F.U.M Ministrisë së Drejtësisë
4. Propozim, për privatizimin e 13 makinerive të F.U.M sipas listës së paraqitur në relacionin, drejtuar Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit
5. Kalimin kapital të 13 makinerive të repartit të modeleve, sipas listës që ndodhet në relacion, nga F.U.M në Uzinën Mekanike Tiranë (U.M.T)
6. Ti lejojë kryerjen e transferimit të magazinës së mjeteve të xhiros, të U.M.T në ambjentet e kësaj uzine, Ministrisë së Drejtësisë
7. Kalimin kapital të 3 objekteve ndërtimore që ndodhen në terotirin e gjykatës, nga U.M.T, Ministrisë së Drejtësisë me emërtimet dhe vlerat e mëposhtme

Menca dhe Klubi	61188 lekë
Reparti i bokollave të bronxit	146436 lekë
Depa karburanti	5720 lekë
SHUMA	213344 lekë

8. Celjen e fondit për çdo muaj për Ndërmarrjen Fonderia e Uzinës Mekanike si më poshtë:

1. Paga	155347 lekë
2. Sigurime shoqërore	63909 lekë
3. Polici private	48000 lekë
4. Shpenzime operative	70000 lekë
SHUMA	337256 lekë

9. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi si dhe përgatitjen e urdhërave përkatës ngarkohen:

Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Ekonomike, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik si dhe Ndërmarrjet Fonderia e Uzinës Mekanike, Uzina e Pjesëve të Ndrimit për Autotraktorë dhe Uzina Mekanike Tiranë.

10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

Leonidha TOSKA